



Enkeleda Pano

Mban pozicionin e Këshilltarit të Ministrit të Drejtësisë që nga muaji dhjetor 2021. Znj. Pano është e diplomuar pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, në Universitetin e Tiranës, ku në vazhdim ndjek ciklin e studimeve për gradën Doktor i Shkencave. Ka kryer kualifikime profesionale të shumta brenda dhe jashtë vendit në fushën e shërbimeve sociale, marrëdhënieve me jashtë dhe të komunikimit. Ka botuar publikime si autore e parë në revista prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare. Zonja Pano ka një eksperiencë të pasur profesionale mbi 15 vjeçare, kur ka filluar karrierën fillimisht si nëpunëse pranë Ministrisë së Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ka qënë lektore e jashtme pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, koordinatore projektesh në organizatën ndërkombëtare Gallup Europe, nëpunëse civile pranë Bashkisë së Tiranës dhe institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. Zotëron gjuhët angleze dhe italiane.

Fusha e angazhimit: Politikat dhe mbrojtja e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin.